



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 20.03.2019,  
duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rrahmani, Fadil Gashi, Genc Sherifi dhe Egzon Azemi.

**Mungoi:** Blerand Stavileci.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Qëndrim Arifi, përfaqësues i INPO-së dhe Faton Ajeti, përfaqësues i OSCE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta, kryesues.**  
**Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.**

**Vala Peshku** tha se tani që e morëm rendin e ditës, është shtuar edhe një pikë e rendit të ditës, mirëpo në rendin e ditës, të mëparshmin, pikë e dytë ka qenë "Propozimvendimi për kalimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në pronësi të Komunës së Prishtinës", tani qenka përmirësuar në "Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës, për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP-ja në ndërmarrje publike lokale, në rregull është.

**Halim Halimi** shprehu mendimin se do të ishte mirë që në mbledhje të Komitetit për Politikë e Financa të ishte në rend dite, së paku të dakordohemi që për Kuvend të jetë "Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2018 në vitin 2019", ngase e dimë se punëtorët e ndërmarrjes "Pallati i Rinisë" ende nuk i kanë marrë pagat, sepse muaji mars është koha kur duhet të bëhet bartja e buxhetit.

**Valbona Ahmeti - Makolli** bëri të ditur se kryetari ka propozuar që gjatë kësaj jave të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme lidhur me bartjen e buxhetit, d.m.th. para takimit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit.

**Eman Rrahmani** propozoi që si pikë e rendit të ditës të jetë edhe kërkesa për auditimin e ndërmarrjeve publike, pra duhet auditimi financiar dhe auditimi i performancës në të gjitha ndërmarrjet publike të Komunës së Prishtinës.

**Vala Peshku** tha se këto propozime duhet të jepen në Kuvend.

**Agim Gashi** theksoi se propozimet munden të jepen në Komitet, çka janë për Komitet shkojnë në Komitet, çka nuk janë shkojnë në Kuvend, kështu që kryesuesi merr ide prej anëtarëve të Komitetit, sepse rendin e ditës e bën kryesuesi, në bashkëpunim me kryetarin, kështu që keni të drejtë të propozoni.

Ai në vazhdim tha se në disa fshatra të Gollakut mungon shërbimi i transportit, për shkak të numrit të vogël të banorëve të asaj ane dhe jo rentabilitetit në shërbime përkatëse, ndërsa roli i Komunës është i pazëvendësueshëm në stabilizimin e jetës në këtë fushë. Si ide është që të ngrihet në Kuvend ose përmes pikës së rendit të ditës, ose do ta paraqesim direkt, mirëpo do të ishte mirë të konsultoheni me kryetarin dhe të gjeni një mirëkuptim, që të diskutojmë dhe ta gjejmë një modus të rregullimit të kësaj çështje, për shkak se mund të ndryshohet në Kuvend Rregullorja për linja, por nëse nuk ka nevojë, atëherë mundet direkt në kompetencë të Shërbimeve Publike, por mund ta bëhet edhe me zgjatjen e linjave, pastaj nëse ka nevojë Kuvendi mund të marrë ndonjë vendim për ndarjen e mjeteve për subvencionim.

**Valbona Ahmeti - Makolli** bëri sqarime lidhur me diskutimin e Emanit, duke thënë se Komuna e Prishtinës i ka pasur një muaj, në muajin tetor, auditorët e jashtëm dhe tash janë pesë javë, prej 3 marsit deri me 5 prill. Unë i kam pyetur auditorët e jashtëm lidhur me ndërmarrjet publike se si shkon puna, dhe janë përgjigjur se edhe ne e kemi atë plan dhe e bëjmë auditimin sikurse Komuna, Qeveri etj.

Sa i përket auditimit të performancës, vjet i kemi pasur dy në Komunën e Prishtinës, është fjala për performancën e të hyrave dhe performancën e subvencioneve, që i ka bërë vetëm për subvencione, jo të gjeturat, mirëpo ende nuk kanë dalë rezultatet preliminare, mirëpo i kemi pasur dy aktgjykime, ZKA-ja e kishte plan me bërë auditim në ndërmarrjet komunale, por sa i përket auditimit komunal nuk e di sa kanë të drejtë.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ky**

#### **REND I DITËS:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Prishtinës;**
- 3. Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës për inicimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrje publike lokale;**
- 4. Propozimvendimi për lënie në dispozicion të Projektdokumentit për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re -Zona Lindje";**

Faqe 2 nga 7

5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Holtikultura ", SHA në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit;
8. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të vrrarëve prishtinas në pesëvjeçarin e parë pas luftës së dytë botërore;
9. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimave të luftës së vitit 1999 të lagjes "Sofalia" ;
10. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

#### **Pika e dytë**

**Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Prishtinës;**

**Kryesuesi** tha kjo ka si ndryshim në qasje të fundit, është kërkesë prej Komunës së Obiliqit, në fakte është edhe si iniciativë, me qëllim që aplikimi të bëhet sa më shpejt dhe të funksionalizohet. **Agim Gashi** i parashtrroi pyetje drejtoreshës së Financave, se a ka implikime buxhetore marrëveshja, sepse bëhet fjalë për ndërtimin e një rruge, nga e cila preken të gjitha këto komuna. **Kryesuesi** tha se kjo është në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal, ka hyrë në projekte të përbashkëta.

**Agim Gashi** kërkoi të dijë se a financohet nga buxheti i këtyre komunave apo nga Qeveria.

**Kryesuesi** tha se financimi bëhet nga niveli qendror, por duhet aplikuar.

**Fatos Dibra** tha se të gjitha këto marrëveshje janë që komunat me u angazhuar me kërkuar financim nga niveli qendror.

**Kryesuesi** u shpreh se bashkëpunimi ndërkomunal në njëfarë mënyre, është kusht për të aplikuar në ato grante që kanë me u dedikuar për ndërtim. Lidhur me këtë më gjerësisht diskutojmë në Kuvend, se ka material shumë, e qëllimi është që të autorizohet kryetari për të diskutuar për këtë çështje.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Komunës së Obiliqit, Komunës së Podujevës dhe Komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrje publike lokale.**

**Halim Halimi** tha se kthimi i ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në Komunë të Prishtinës është i mirëseardhur, mirëpo me rëndësi është me ditur ne se a kanë obligime financiare, d.m.th. a i marrim me obligime, me borxhe, siç është fjala për ndërmarrjen "Pallati i Rinisë", pra është mirë ta kemi këtë informatë.

**Fatos Dibra** tha se vetëm ka me u bërë kërkesë në Qeveri për kthimin e kësaj ndërmarrje, nuk besoj që i dimë detalet ende se sa ka borxhe. Kjo është për me ia lejuar Kryetarit me kërkuar nga nivelit qendror iniciimin e procedurave me AKP, që mandej kalon edhe në Kuvend të Kosovës.

**Genc Bashota** dha sqarime, duke cekur se kur ka qenë në bisedime me AKP-në, ata verbalisht kanë thënë se ata janë plus, mirëpo nuk mundem me thënë edhe zyrtarisht pa i parë dokumentet.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e autorizimit Kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave për kthimin e ndërmarrjes shoqërore "Tregjet" nga AKP në ndërmarrje publike lokale dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e katërt**

**Propozimvendimi për lënie në dispozicion të Projektdokumentit për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re -Zona Lindje".**

**Agim Gashi** pyeti se a është fjala për Marigonën.

**Genc Bashota** tha se ky plan ka kaluar në vitin 2017, pastaj nuk ka mundur të zbatohet, për arsye se Qeveria e ka marrë një vendim për shpallje me interes të veçantë, më pastaj Qeveria e ka tërhequr vendimin në një pjesë të Planit, ku janë 190 hektarë, që gjysmën e ka liruar e gjysmën ende e ka. Gjysma që është liruar është edhe e sektorit privat dhe Komuna ka hapësirë të vetën që duhet me u trajtuar, dhe ne e kemi hartuar. Në Kuvendin e Komunës në vitin 2018, e kemi miratuar Vendimin për iniciimin e revidimit të kësaj pjese që ka mbetur, në ndërkohë ne e kemi krijuar një komision mbikëqyrës, që është duke punuar me palët e interesit, përfshirë edhe ne si Komunë e kem një pjesë. Ja që ende se kanë sjellë dokumentacionin komplet.

**Halim Halimi** u shpreh se këto po na përsëritën, andaj qëndrimi im është, së paku atë që e kemi përsëritur gjithë herë, pa Hartë zonale mos me pasur plane rregulluese të hollësishme.

**Agim Gashi** pyeti se a është e vërtetë që Plani zhvillimor komunal ka qenë në procedurë tenderimi, dhe nëse nuk është siç kam informatë, kërkoj falje.

**Genc Bashota** u përgjigj se jo Plani zhvillimor, por mbështetja teknike, dhe tri here është anuluar.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për lënie në dispozicion të Projekt dokumentit për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Hortikultura", SHA, në Prishtinë.**

**Agim Gashi** tha se nëse pronën e Qeverisë ia jep ndërmarrjes "Hortikultura", është vendim i gabuar. Nëse e jep pronën e huaj është vendim i gabueshëm, sepse nuk është pronë e Komunës. **Fadil Gashi** tha se ne i kemi shtatë asambleistë, por pse e kemi vetëm një përfaqësues në Komitet për Politikë e Financa?!

**Kryesuesi** bëri të ditur se kjo do të rregullohet me Udhëzim administrativ, që ka ardhur i ri, tash jemi në diskutime, ka me u ndërrua realisht.

**Halim Halimi** tha se ka pak të drejt Fadili, si po duket PDK - ja ka hequr dorë, anëtari i saj i Komitetit që sa mbledhje nuk ka marrë pjesë, lexojeni Udhëzimin administrativ dhe Ligjin, d.m.th. me sa here mungesë pa arsye.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim NPL "Hortikultura", SHA, në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë.**

**Fatos Dibra** sqaroi se Planin e kanë bërë duke u bazuar në Udhëzimin e vjetër administrativ, siç ka qenë çdo vite me u bërë ky Plan, kurse tani ky ka ndërruar dhe është në fund të vitit. Tash, me Udhëzim e ri Plani duhet me u bërë për katër vjet e jo siç ka qenë çdo vit, kështu që këtë Plan duhet me ndërruar deri në mbledhje të Kuvendit, me e përputhë me udhëzimin e ri që është në fuqi, e mundeni me votuar në Kuvend.

**Kryesuesi** tha se nëse nuk bëhen ndryshimet deri në Kuvend, shtyhet për mbledhjen e radhës.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për transparencë, me kusht që deri në mbledhjen e Kuvendit të bëhen ndryshimet, me u përputhur me Udhëzimin e ri administrativ që është në fuqi, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit.**

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bahri Hoxhës dhe Besnik Asllanit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të vrarëve prishtinas në pesëvjeçarin e parë pas luftës së dytë botërore.**

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimave të luftës së vitit 1999 të lagjes "Sofalia".**

**Vala Peshku** tha se ka të bëjë me dy pikat, nuk i di praktikat si kanë qenë deri tani, por më intereson të dijë se kur sillen projektet për vendosjen e këtyre lapidareve, a konsultohet dikush prej kulturës apo për situatën e tyre, sepse nëse e shikojmë këtë, ky lapidari për banorët e lagjes "Sofali" është si varrezë, kjo tjetra është pak më artistike, kështu që qytetin kemi filluar me shndërruar në objekteve depresive.

**Genc Bashota** dha sqarime, duke cekur se neve në Planifikim na vjen kërkesa dhe ne e trajtojmë në bazë se ata ku e caktojnë lokacionin, a është toka jonë, a e dëmton, a është në harmoni me ambientin, me gjelbërimin, por për dizajn ne si Komunë nuk kujdesemi.

**Vala Peshku** tha se pyetja ime ishte: A kujdeset dikush prej Komunës për dizajnin?

**Genc Bashota** tha jo, ne nuk kujdesemi si Planifikim.

**Sami Boroci** shprehu mendimin se ndoshta është dashur me u trajtuar në rreth më të gjerë, me i përfshirë edhe Drejtorinë e Kulturës, Drejtorin e Urbanizmit, dhe unë personalisht ndoshta jam kundër këtyre lapidarëve, por këto dyja kam me i votuar. Mendoj se do të duhej të krijohej një logjikë tjetër për promovimin e këtyre vlerave qoftë të luftës, qoftë të heronjve, ndoshta me improvizuar ose me nxjerrë një hapësirë të ndonjë muzeu të caktuar, lagje të caktuar, qoftë edhe në pjesë të ndryshme të qytetit, por unë mendoj përmes muzeve e jo përmes lapidarëve. Pajtohem me Valen, se nuk kanë ndonjë dallim prej një varri. Mendoj se Drejtoria e Kulturës duhet me u marrë pak më shumë me punë dhe me shikuar me krijuar ndonjë farë standardi. Unë jam kundër këtyre formave të ngritjes së lapidarëve.

**Agim Gashi** propozoi që këto dy propozime të rikthehen te institucioni përkatës, që janë përgjegjës për të gjitha aspektet e ndërtimit të një vepre që do të jetojë dhe do të përfaqësojë një pjesë të kulturës dhe historisë sonë, sepse vlerat e tilla flasin dhe komunikojnë me gjeneratat e ardhshme. Ne si institucion jemi përgjegjës në aspektin administrativ dhe procedural, por nuk guxojmë me ra në grackën e ndjenjës, ta them "ad hok" dhe është mirë me u rikthyer, me u përgatitur, me u dizajnuar, me ditur për çka po vendosim dhe se nuk dëshirojmë atë vepër me e hequr dhe pas një viti me thënë e kanë punuar keq, nuk është adekuate dhe duhet me e hequr dhe me vendos tjetër.

**Egzon Azemi** theksoi se është rregull që duhet të jenë disa kritere të caktuara sa i përket dizajnit dhe këto me i inspektuar, në këtë rast Urbanizmi, sepse është përgjegjësi e tyre. Mirë që më në fund duhet me ardhur një rast që është tipik i yni, që është një rast i shqiptarëve, që kemi me pasur guxim me folur, se nuk e kemi pasur këtë guxim me folur kur është ardhur lapidari i KFOR-it, në sheshin "Nënë Tereza", dhe nuk është njëfarë dëmi i madh edhe me qenë objekti më i shëmtuar që vendoset në lagjen "Sofalia", sepse përveç banorëve të lagjes që kanë nënshkruar për me u bërë atje lapidari dhe rrallë ndonjë qytetarë që kalon atë lagje e nuk ka me parë, ndërsa në sheshin "Nënë Tereza" kemi votuar vetë secili prej neve, një objekt që asnjë nuk kemi folur, e tani lehtë flasim dhe kërkojmë kritere. Mos të nisemi me standarde të dyfishta.

**Vala Peshku** tha se nuk jam për me i kthyer këto dy dyja, sepse shumë prej partive që janë këtu prezentë, që kanë vepruar 20 vjet dhe kanë menaxhuar me Prishtinën, nëse dikush e kishte pasur seriozisht këtë punë, e kishte pasur në kohë të vetë e jo sot kur nuk është në pushtet. Nuk jam me e kthyer lapidarit dhe kjo nuk është thirrja ime.

Po ashtu, Egzon, pllaka e NATO-së, nëse e ke vërejtur, në botë krejt janë të njëjta të KFOR-it, gjithkund ku i vendosin i kanë të njëjta. Këto lapidaret janë të parat që po vinë te ne prej që jemi në Kuvend komunal. E kemi pasur përpara të KFOR-it dhe nuk ka pasur tjetër. Për mua është hera e parë që ballafaqohem me dy dizajne të tilla.

**Halim Halimi** tha se unë e shoh që të gjithë jemi me miratuar dhe të përcillet për Kuvend.


**Genc Bashota** kërkoi sqarim për një informatë, duke thënë se kur ka qenë puna e KFOR-it, Egzon, ka ardhur ministri i Mbrojtjes, z. Burim Ramadani, dhe gjashtë pjesëtarë të KFOR-it, dy prej tyre kanë qenë gjeneralë brigade, dhe kanë thënë se kjo është pllaka, ky dizajni që është miratua në Komitetin e NATOS në Bruksel, asnjë pikë as presje nuk dua me e prekë, është Vendim i Komitetit Ministrorë të NATO-së, është çështje e ndjeshme. Për lokacionin i kanë kërkuar tri vende, jemi pajtuar për lokacionin ku është tash.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratuan Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit kushtuar të vrrarëve prishtinas në pesëvjeçarin e parë pas luftës së dytë botërore, dhe Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar viktimave të luftës së vitit 1999 të lagjes "Sofalia", dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kuleta



Faqe 7 nga 7